



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 25/09/2025

PROCES VERBAL

Takimi me Grupin e Punës për Paketën Fiskale 2026

Vendi : Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Përmet

Ora : 10:00

Tema e konsultimit : Paketa Fiskale 2026

I mbajtur sot më datë 25 Shtator, pranë sallës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Të pranishëm në këtë konsultim janë nënkryetari z.Florand Hasani, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësi, Turizëm znj.Etleva Myftari, administratorët e njësive dhe punonjës të tjerë.

Takimi u hap nga znj.Myftari e cila përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë. Më tej ajo theksoi rëndësinë e këtij takimi lidhur me Paketën Fiskale për vitin e ardhshëm. Ajo gjithashtu vlerësoi angazhimin e të gjithë njësive për procesin e mbledhjes së taksave. Në vijim të fjalës ajo kërkoi nga punonjësit e njësive një raportim të detajuar të gjëndjes aktuale lidhur me realizimin e mbledhjes së taksave vjetore.

Duke vazhduar ajo u kërkoi të kenë gati planifikimet e vitit 2026 brenda muajit tetor. Gjithashtu u shprehu mbështetje maksimale administratorëve të njësive për të realizuar këtë proces mjaft të rëndësishëm për të ardhurat e bashkisë.

Në përfundim të fjalës së saj znj.Myftari falenderoi dhe një herë pjesëmarrësit dhe u shpreh e hapur për të dëgjuar nga ta problematika dhe sugjerime.

Disa nga problematikat e dala nga ky takim janë :

- Vështirësi në mbledhjen e taksave
- Nevoja për pastrim i kanaleve vaditëse
- Problematika me ndryshimet hipotekore të truallit
- Shtimi i tarifës së infrastrukturës rrugore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

- Mbledhja e tarifës së mirëmbajtjes

Pas sugjerimeve nga Grupi i Punës , Nën Kryetari i vuri edhe një herë në dukje se duhet të angazhohemi të gjithë së bashku për të hartuar sa më shpejt dokumentin draft për Paketën Fiskale me qëllim fillimin e konsultimeve publike me grupet e interesit.

Takimi u mbyll në orën **11:00**.

Konceptoi: Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURRO



Foto nga takimi:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

